

**HAJRI SHEHU**

**AVDYL SULA, *FJALOR FJALËSH DHE SHPREHJESH*  
*POPULLORE, EMAL, TIRANË, 2009***

Kohë më parë doli nga shtypi “Fjalor fjalësh dhe shprehjesh popullore” i Avdyl Sulës, botuar nga shtëpia botuese “EMAL”, Tiranë.

Fjalori zë një vend nderi ndër fjalorët e tjerë me fjalë e shprehje popullore nga krahinat, botuar deri më tani. Vlera kryesore e këtij fjalori është lënda e tij e pasur leksikore e frazeologjike, e qëmtuar me kujdesin dhe dashurinë e një leksikografi tashmë të formuar\*. Kjo vepër, sikurse shkruan autori në parathënie, është fryt i një pune 30-vjeçare. Ajo shpalos

---

\* Në vitin 1983 kam qenë me shërbim në Tropojë, i ngarkuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, për të ndihmuar Aksionin Kombëtar për Mbledhjen e Fjalëve dhe të Shprehjeve Popullore. Gjatë takimeve në seksionin e arsimit të rrethit dhe në kabinetin pedagogjik, më rekomanduan të takoja edhe një leksikograf të ri, Avdyl Sulën. Fillimisht më përshkoi një hije mosbesimi. Ai punonte në aparatën e komitetit të Partisë të rrethit; ndaj, për vetë natyrën e punës së tij zyrtare, mendoja se e kishte vështirë të arrinte ndonjë sukses të dukshëm në këtë fushë.

Gjithsesi e takova. Ai më priti me përzemërsi, sikur njiheshim prej kohësh dhe më ftoi të uleshim në një lokal për të pirë kafe. Ndërkohë, më vuri në dijeni për punën hulumtuese që bënte në këtë lëmë, për çka e përgëzova e shkëmbyem mendime. Gjatë bisedës, mësova se ai kishte shkuar student në universitetin e Shkodrës prej punëtor, i kishte kryer studimet me përfundime shumë të mira dhe kishte punuar mësues në një fshat të thellë të rrethit. Kjo ma largoi hijen e mosbesimit që pata në fillim, sepse krijova përshtypjen se ai do ta ruante frymën e punëtorisë, në gjirin e së cilës ishte brumosur në rini, se do ta ruante shpirtin e punëtorit këmbëngulës edhe në këtë veprimtari. Dhe, me këtë përshtypje, sa u ktheva në Tiranë, i dërgova një udhëzues për mbledhjen e fjalëve e të shprehjeve popullore, që kishte botuar Instituti i Gjuhësisë.

Vitet rrodhën vrullshëm. Kolegët e mi dhe unë ndoqëm me ngazëllim dorëshkrimet që dërgonte fillimisht Avdyli në Institutin e Gjuhësisë dhe botimet e tij të pastajme në revistat shkencore *Gjuha jonë* e *Studime filologjike* e më pas, në *Gjuha shqipe*, në Prishtinë. Ndërkohë, ai doli para lexuesve me librat “Visare Gjuhësore-Kulturore nga Malësia e Gjakovës” në vitet 2000 dhe 2003, të cilët përfshinin fjalë të rralla dhe shprehje frazeologjike. Këto botime do të mjaftonin për t’i shënuar autorit një emër të nderuar në historikun e leksikografisë sonë.

rreth 15 mijë njësi. Në këtë fjalor lexuesi gjen fjalë me kuptim konkret nga fusha të ndryshme: nga bujqësia e blegtoaria, nga bimësia, shpendët e kandrrat, veshjet, mjetet e punës e orenditë etj. Shih, p.sh. **gurgalem** *m.* brukth, **kripëz** *f.* gram, **larc**, **-i** *m.* larth, ashe, **lilan** *m.* jargavan, **rrafshor** *m.* zdrukth i madh e i gjatë, **mbulojsë** *f.* mbulesë, mbulojë, **kullojsë** *f.* kullorë etj. Shumë fjalë shënojnë kuptime dhe cilësi abstrakte: **alltias** *ndajf.* rrufeshëm, flakë për flakë; **arushas** *ndajf.* grykë në grykë, fytas; **ashtthatë** *mb.* i bërë kockë e lëkurë; **barrëvram/ë**, **-e** *mb.* orëvvarë; **bathuq** (lexo *bat-huq*) *mb.* hutaq, i marrë, guhak; **besëlanës** *mb.* që nuk e mban besën; **besëlypës** *mb.* që lyp besë; **deracak**, **-e** *mb.* që bredh derë në derë; **fjalëtopuz**, **-e** *mb.* fjalërendë; **hijenik** *mb.* që intrigon mbas krahëve; **hjekësoj** *kal.* tradhtoj, pres në besë; **mendjeshul** *mb.* kokëbosh, mendjefyell; **kulpnak** *m.* dhe *mb.* kulpër e trashë etj.; *fig.* dredharak; **mirashejtas** *ndajf.* drejtpërdrejt, haptazi; pa të keq, çiltas; **shtatanik**, **-e** *mb.* *fig.* i padurueshëm, i rrëmbyeshëm; **zezan** *mb.* dhe si *em.* fatzi; i humbur, qyqar etj.

Fjalori ka shumë fjalë të përbëra populllore. Lidhja e brendshme e gjymtyrëve të fjalëve të përbëra është shumë e tejdukshme. Ky lloj motivimi i ka bërë ato shumë të kuptueshme, rrjedhimisht, edhe shumë të përdorshme. Shih, p.sh. **gjakegër** *mb.* i ashpër, i vrazhdë; **gjakngrim/ë**, **-e** *mb.* dhe si *ndajf.* zemërngjirë; **gjakfëlliqun** *mb.* i zvetënuar, i bastarduar etj. Vetëm me pjesën e parë **krye-** gjejmë rreth 70 fjalë të përbëra: *kryebucelë, kryecuklan, kryecumrak, kryefyell, kryegolare, kryelidhun, kryemadhe* (troftë e madhe), *kryengul, kryerrasët* etj. Dhjetëra fjalë të përbëra ka me **bark, dorë, krah** etj.: *barkbucelë, barkdaulle, barkkulshedër, barkshekë, barkpangimë, barkllullë; dorënguruem, dorëpambuk, dorëplumb, dorështjerrun, dorëtopuz* etj.

Për t'u dhënë sa më shumë jetë e hapësirë fjalëve që ka qëmtuar e grumbulluar, autori ka përdorur një metodë mjaft frytdhënëse. Dorëshkrimet e botimet e mëparshme i ka përdorur si pyetësorë për studiues e kolegë për të vërtetësuar lëndën e tyre edhe në të folme të tjera, përveç asaj të vendlindjes së tij, Tropojës apo të atyre që ka mbledhur në të folme të veçanta. Këtë synim, falë edhe ndihmës së tyre, ai e ka arritur suksesshëm dhe ka shënuar përbri fjalëve të shpjeguara edhe të folmet ku ato përdoren. Një metodë mjaft e vyer për të parë gjeografinë e fjalës e për të krijuar edhe atlase leksikografike sepse na japin izoglosa leksikore të shqipes e njëherësh dëshmojnë për njësinë (unitetin) e saj. Në këtë mënyrë, ky Fjalor, ndryshe nga disa fjalorë të tjerë krahinorë, ka marrë frymëmarrje të shëndetshme dhe përmasa e vlera të spikatura. Pjesa më e madhe e fjalësit të tij ka përdorim

aktiv në shumicën e të folmeve të gegërishtes, nga Kosova deri në Tiranë. Si të tilla, ato janë përgjithësisht me vlera potenciale për gjuhën e përbashkët letrare, e thënë ndryshe, të vlefshme për të fituar “të drejtën e qytetarisë” edhe në gjuhën shqipe standarde.

Për t’i bërë sa më të qarta fjalët e pasqyruara, autori ka dhënë edhe motivimin fjalëformues a historinë kuptimore të disave prej tyre, çka e pati bërë edhe te “Visare Gjuhësore-Kulturore nga Malësia e Gjakovës (vëllimi I). Shih, p.sh. *bathuq* (prej *bat+huq* humb), *paja* (prej *pa+eja*), *spikëtoj* (prej *spik+toj*). Kjo e lehtëson lexuesin për të rrokur më lehtë kuptimet dhe prejardhjen e tyre. Kjo është njëherësh, një shkrim i tyre morfologjik.

Lexuesit e studiuesit gjejnë në këtë vepër një thesar njësisht frazeologjike, fjalësh të urta a proverbash, të cilat karakterizohen, siç dihet, nga figurshmëria e thukët dhe e goditur. Ja disa nga ato: **Asht për me kullotë (për me marrë) bleta në të** (për një vajzë a një grua) është shumë e bukur, është bash si lule; **E gjuen diellin me gurë iron.** bën marrëzi, kryen veprime të pamatura e qesharake; **I ranë shtatë ylbera (diej) në ballë (për fytyrë)** i ndriti fytyra prej gëzimi, iu bë zemra mal; **Bân dritë në terr** (një vajzë a një grua) është shumë e bukur, është si yll drite, shkëlqen ndër shoqe; **Flet për Shkup e për Shkodër** është llafazan i madh; është portë pazari; **Gjarpni fle, ai e nguc me krande (gjarpni mblidhet kutullaç, ai shkon me ia ngjitë kërpeshin)** iron. e lyp vetë të keqen; e kërkon sherrin me qiri; **E muer kryet nën sqetull e shkoi** u largua kryezënë e i turpëruar; **Ai e mban tupanin, të tjerët i bien iron.** thuhet kryesisht për një drejtues kukull, që e përdorin të tjerët si gur shahu; **Ësht mashkull sa për rend të ujit** është i papërfillshëm; nuk bën hije në diell; **Hangri kambë e dorë** u përbetua me përgjërime për diçka; **Hanë në gojë të njani-tjetrit** duhen pa masë; **Ik deri të ndeshesh për mur!** Tërhiqur e shmangiu ngatërresës!; **Ka le me hanë ndejë** nuk shqetësohet për asgjë. **Ka lanë kambë e dorë** është robtuar së tepërmi; **Me i ra hunda në tokë, nuk ndalet me e marrë** është tejet mendjemadh; **Ngul kambë si mushka në akull** tregohet tejet kryeneç. **S’i ka qitë nana shami për fytyrë kur ka le shak.** tregohet i paturpshëm etj.

Autori e pasuron me këtë vepër inventarin e gjuhës sonë dhe me një numër të konsiderueshëm tabush dhe eufemizmash, si (për orët e zanat): *të bardhat, të lumet, fatmirat, të mirat*; (për djallin): *brigrremçi, bripërdredhuni, kambëkëputuni, kambëmalkuemi, kambëtersi, punëharami, punëligu, punëmbraçshti, punëtersi, punëziu*; (për ujkun a gjarpnin): *gojëndrymi, gojënguruemi, gojëhelmti* etj.

Fjalori është me interes të gjerë jo vetëm për leksikografinë e frazeografinë, por edhe për dialektologjinë, morfologjinë etj. Të tërheqin vëmendjen në mënyrë të veçantë fjalëformimet karakteristike. Këto janë më shumë se ato të botuara në “Visare Gjuhësore-Kulturore nga Malësia e Gjakovës” (vëllimi I). Kështu, me prapashtesën **-an**, për të cilën Sula ka argumentuar se ka prejardhje indoeuropiane, dalin në dritë qindra fjalë, si *balushan, cungan, çmendani, çubardhan, çuçullan, dergjan, egërcan (egërtan), fëlliçan, frigan, gulshan, haparan, hirran, hupan, hutan, kalbësan, klluqan, marran, mbrapshtan* etj. Autori ka vërtetësuar se këto fjalë përdoren në Kosovë, Tropojë, Pukë e deri në Lezhë.

Prapashtesa **-ëz**, e njohur në gjuhën letrare për formim emrash kryesisht me kuptim zvogëlues, del e frytshme dhe në emra pa këtë kuptim, si *ndërbarkëz, ndërbishtëz, ndërhundëz, edhëz, viçëz* etj. Parashtesa **pa-** përdoret shumë shpesh, sidomos për formimin e ndajfoljeve me kuptim të kundërt nga ai i fjalës pa këtë parashtesë: *paanshën, paburrnisht, padashtas, pahijshëm, pakandshëm, pandashëm, panatyrshëm, panevojshëm, pangeshëm, panjerëzishëm, papjekunisht, paprajshëm, patrimnisht* etj. Ajo del dhe në mes të mbiemrave të përbërë me këtë kuptim: *barkpangimë, ditëpagëzues, ditëpapamë, gjakpafalun, gjakpapërlyem, mullëpangimë, punëpakryem, pushkëpavarun, sypangimë, shpirtpangimë, shtatpalidhun, vorrpabamë* etj. Prodhimtare shfaqet dhe parashtesa **kala-**, pak e njohur në gjuhën letrare, e cila ndihmon për të formuar fjalë (emra, mbiemra, folje e ndajfolje) me kuptim intensiv, përforcues: *kaladredhan, kaladredhajkë, kaladredhazi, kaladredhim, kaladredhoj / kaladredhohem; kalakryqoj / kalakryqohem; kalakryqas; kalabosh* etj. Prapashtesa **-amë** del në një numër emrash, si *cokamë, luhamë, ngucamë, pehamë, picamë, vilikamë, zuçamë* etj. Po kështu, prapashtesa **-osh** (*dajosh, hundosh* etj.) e **-uk/-uke/-ujkë** (*dajuk, minuk, mixhuk, vejuk, viçuk, viçuke, mbesuke, drequk-drequjkë, mjeshhtëruk* etj.). Interes paraqesin edhe disa ndajfolje e pasthirrma të njëfjalëzuara me përngjitje, si *hejseku, hejsekur, herdokur; kamoti, ehuha, ehuho, hamadreq, mozomakeq* (prej *mos o Zot ma keq!*) etj.

Për të ruajtur ngjyresën e të folmeve, autori i ka pasqyruar fjalët e shprehjet në gegërishte, por në një gegërishte sa më përfaqësuese. Mendojmë se kjo u jep dorë studiuesve e lëvruesve të shqipes për t’i rindërtuar e për t’i përgjithësuar në fjalorët e gjuhës së përbashkët, për të njohur më tej dukuritë dialektore të gjuhës sonë për t’i përdorur natyrshëm në ligjërime dhe tekste të ndryshme.

Me këtë Fjalor leksikografia jonë pasurohet dukshëm. Për këtë dëshiroj të citoj kolegun nga Prishtina, dr. Mehmet Halimin, i cili për librin “Visare

Gjuhësore-Kulturore nga Malësia e Gjakovës” (II) të këtij studiuesi, ka shkruar: “Autori ka punuar me dashuri dhe përkushtim. Ai ka arritur të hartojë një vepër të rëndësishme për të gjithë ata që e duan, e ruajnë dhe e kultivojnë gjuhën tonë amtare. Kjo vepër gjuhësore është shumë e dobishme dhe shquhet për vlera kulturore e shkencore të pakrahasueshme, ndaj publikimi i saj pasuron kulturën tonë gjuhësore”. Këtë vlerësim meriton plotësisht edhe ky fjalor. Ai është vërtet fryt i një jete të tërë, i një pune të gjatë e të përkushtuar, të frymëzuar nga dashuria për gjuhën tonë amtare. Fjalori sjell shumë mesazhe. Ai dëshmon se gjuha jonë është vitale, se ajo ruan thesare në të folmet e dialektet e saj. Të folmet e dialektet e shqipes janë burime të pashtershme për pasurimin e zhvillimin e gjuhës së përbashkët letrare, sidomos sot, kur ajo përballet me trysni e ndikime të panevojshme nga gjuhë të huaja.

Avdyl Sula është prototipi i dijetarit këmbëngulës e me vullnet të paepur. Dimë që Avdyl Sula është shprehur në mjetet e informimit masiv se ka në përfundim një libër tjetër me rreth 7 mijë fjalë të urta, urime, mallkime e betime. Kjo do të thotë se deri më sot ai sjell prurjet më të mëdha në këtë fushë dhe meriton, vërtet përgëzime.

